



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
Mbledhja nr. 19
Prishtinë, më 28 shtator 2010, në orën 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C- 203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Kosara Nikoliq, Gani Koci, Naser Osmani, Anita Morina-Saraçi, Riza Smaka, Synavere Rysha dhe Enis Kervan.

Të ftuar: Lage Olofsson – auditor i përgjithshëm - mungoi, Ibrahim Gjylderen zv.auditor, Beza Halilaj dhe Faruk Rrahmani - ZAP.

Të pranishëm: Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri - zyrtare ligjore, Musa Rudaku – zyrtar i fushës së ekonomisë dhe të financave, KIPRED (staf mbështetës) - Artan Venhari dhe Albert Krasniqi, Shpresa Miftari – praktikante, Qëndresa Mulaj – ZAP dhe Driton Selmanaj – KDI, Shefki Kastrati –NDI dhe Lejla Selimi –OSBE.

Mbledhjen e kryesoi Haki Shatri - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës

1. **Miratimi i rendit të ditës,**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 21 shtatorit 2010;**
3. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009;**
4. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009;**
5. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës;**
6. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Safete Hadergjonaj – Komisioni duhet të debatojë, a do të shqyrtohen të gjitha raportet (një nga një), apo Komisioni do të bëjë përzgjedhje nga raporti vjetor i ZAP-it, cili raport do të shqyrtohet. Përzgjedhja e raporteve individuale për shqyrtim në këtë mbledhje nga kryetari i Komisionit nuk është e arsyeshme, sepse për këtë duhet të konsultohen anëtarët e Komisionit.

Kryesuesi – Janë një numër i raporteve individuale të proceduara në Kuvend para pushimeve, disa prej të cilave ky Komisioni ka shqyrtuar e të tjerat presin për shqyrtim. Komisioni nga Raporti vjetor i auditorit do të vendosë cilat raporte individuale të organizatave buxhetore do të jenë prioritet për shqyrtim dhe cilat dëgjime publike do t'i organizojë.

Safete Hadergjonaj - Kërkoj që edhe anëtarët e Komisionit të kenë këtë regjistër të raporteve, të cilat janë në pritje për shqyrtim.

Gani Koci – Komisioni ndoshta do të duhej të bënte një përzgjidhje në kuptimin pozitiv. Agjenda e këtij Komisioni varet nga ZAP-i. Meqenëse kjo agjendë mund të përcaktohet paraprakisht, atëherë anëtarët e Komisionit duhet të përcaktohen se cili raport do të shqyrtohet.

Synavere Rysha – Komisioni duhet të përqendrohet në ato institucione në të cilat ka më tepër shkelje dhe të hartojë edhe raporte të tjera, krahas raportit që e ka bërë auditori. Pyes: Cilat raporte duhet të shqyrtohen në Kuvend? Raporti vjetor i ZAP-it duhet të shqyrtohet në Kuvend me sugjerimet e këtij Komisioni. Po ashtu, nëse një institucion ka shumë mangësi, atëherë Komisioni duhet të vendosë që edhe ai raport të kalojë në Kuvend për shqyrtim.

Kryesuesi konstatoi se lista e raporteve që presin për shqyrtim nga Komisioni, iu dha anëtarëve të Komisionit.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit i mbledhjes së 21 shtatorit 2010

Safete Hadergjonaj – Tha se në diskutimin e saj për Raportin vjetor të auditimit ka ndërhyrje. Ajo ka thënë se “...është kërkuar nga ne që institucionet e pavarura të kenë mjetet që i kërkojnë. Jemi përpjekur që këtyre institucioneve, ashtu sikurse Zyrës së Auditorit, t'u krijojmë kushte. Megjithatë mbetet shumë për t'u bërë që këto institucione të kenë pavarësi...”.

Gani Koci – Tha se në mbledhjen e kaluar është zhvilluar një debat ndërmjet tij dhe auditorit të përgjithshëm rreth çështjes të cilën e ngriti auditori i përgjithshëm: “... nuk i përgjigjet askujt...”. Kundërshtimi i tij ka qenë se raportet e auditorit i nënshtrohen shqyrtimit në Kuvend. Kërkoi që edhe kjo pjesë e diskutimit ndërmjet tij dhe auditorit të përfshihet në procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi procesverbalin e mbledhjes së 21 shtatorit 2010 me vërejtjet e deputetes Safete Hadergjonaj dhe të Gani Kocit.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009

Kryesuesi konstatoi, meqenëse sekretari i Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, megjithëse ishte ftuar, nuk ishte i pranishëm në mbledhje, shqyrtimi i këtij Raporti duhet të shtyhet për mbledhjen e radhës të Komisionit.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009

Kryesuesi – Opinioni i auditorit për këtë raport është “*opinion i pakualifikuar*”. Vërejtjet dhe të gjeturat e tjera janë: evidencimi i pasaktë i të hyrave, që lidhet me Agjencinë e Veterinës dhe të Ushqimit (AVU). Ky institucion iu ka bashkangjitur ZKM-së në vitin 2009. Megjithatë kjo mangësi gjatë vitit duhet të përcillet dhe të evitohet. Shpenzimet e tjera janë në pajtim me buxhetin. Shpenzimet me derivatet e naftës dhe të automjeteve në të ardhmen duhet të jenë më të

menaxhueshme, sepse ka tejkalime deri në 50% në raport me vendimin e Kryeministrit për këtë çështje. Vërejtjet e tjera janë më tepër të natyrës formale e jo materiale.

Riza Smaka - Ishte i kënaqur me të gjeturat e ZAP-it. Rekomandimi se duhet të bëhet përmirësimi i bazës ligjore po përsëritet te të gjitha institucionet. D.m.th. nuk është e plotë baza ligjore. Lidhur me këtë nisma më së miri merret nga vetë këto institucione, aty ku mendohet se ka mungesë të bazës ligjore. Rekomandimi 2: “...angazhimi që të bëhet menaxhimi më i mirë i telefonave...” nuk është gjë e mirë, sepse është çështje teknike dhe mund të bëhet lehtë. Duhet të rritet kujdesi për kontratën, si në forme, ashtu edhe në përmbajtje. Rekomandimin 5 e ndërlidh me një mocion, që ia ka bërë Ministrisë për Administratë Publike me pyetjen: *Sa vetura ka Qeveria? Përgjigjja ishte: Nuk e dimë.* Asetet qeveritare do të duhej të ishin të inventarizuara dhe të valutuar sipas ligjit.

Synavere Rysha – Raportin e vlerësoi të pranueshëm. Sipas raportit dobësi janë vërejtur në menaxhimin e të hyrave, sidomos te të hyrat nga doganat, AVU, ku të hyrat mbledhen pa bazë ligjore. Qeveria thirret se po i përkrah prodhimet vendore, ndërsa nga ky Raport shihet se po ndëshkohen, sidomos me blerjen e barnave dhe të produkteve, të cilat që në momentin që hyjnë në Kosovë tatimohen në mënyrë të kundërligjshme. Një e mangësi tjetër është zbatimi i proceduarve të prokurimit. Nëse është shkelur Ligji i prokurimit, gjithçka është shkelur në Qeverinë e Kosovës. Sipas Raportit shpenzimet për karburante, për dreka, për darka zyrtare, për vitin 2009 janë rritur. Shpenzimet për karburante janë aq të larta sa ua kalojnë edhe qeverive të tjera. Sistemi i kontrollit ka mungesa të mëdha. Nëpër disa ministri, si rasti i ministrisë, e cila është quajtur “ministri lidere”, nuk ka pasur auditor të brendshëm.

Safete Hadergjonaj – Opinioni kryesor i auditorit është se “*pasqyrat financiare paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë*”. Të gjitha ato dobësi, të cilat janë konstatuar nga auditori, nuk ndikojnë në besueshmërinë e pasqyrave financiare. Në vitin 2008 auditori i ka dhënë nëntë rekomandime për ZKM-në dhe katër rekomandime kanë qenë për AVU-në. Nga këto rekomandime janë zbatuar nëntë, kurse sa u përket katër rekomandimeve të tjera, nuk e dimë cila nuk i ka zbatuar: ZKM-ja apo AVU-ja, e cila më vonë i është bashkangjitur ZKM-së. Kuvendi është ai që ka vendosur që kjo Agjenci të jetë në kuadër të ZKM-së. Raportimi i të hyrave ka filluar nga 1 shtatori i vitit 2009, d.m.th. kjo Agjenci, në këtë kohë ka pasur shumë probleme që të pozicionohet komplet në ZKM. Edhe pse ky pozicionim është bërë me vonesë, nuk mund të ketë dilema që udhëzimet administrative dhe aktet nënligjore, në përgjithësi, duhet të nxirren në mënyrë që të rregullohet mënyra e inkasimit të të hyrave. Sa i përket shpenzimit të telefonave, sipas ZKM-së, janë marrë masa. Gjendja që është trashëguar në mirëmbajtjen e makinave, në telefonata, në përgjithësi është vështirë për t’u zgjidhur si problem. Që nga viti 2004, kategoria e makinave dhe kategoria e telefonatave kanë qenë vazhdimisht të diskutueshme. Qeveria duhet të jetë aktive në këtë drejtim, por edhe deputetët duhet ta kryejnë punën e tyre që me një kontroll efikase të mënjanojnë mangësitë. Sa i përket kontrollit të brendshëm, krahasuar me vitet e tjera, ky vit qëndron shumë më mirë, por ka vend për përmirësime të mëtejshme.

Enis Kervan – Kur flitet për raportet e auditimit, përveç të gjeturave, duhet të flitet edhe për gjëra pozitive, edhe komentet që u japin të drejtë edhe palëve. D.m.th. e kemi këtu rekomandimin 1 “*Ushtrimin e fushëveprimit të AVU-së në të gjitha pikat kufitare me qëllim të sigurisë së shëndetit publik dhe të arritjes së inkasimit të mjeteve*”. Çështja e AVU-së është gati për zgjidhje, mirëpo ajo nuk qëndron vetëm lidhur me këtë, sepse pikat G1 dhe G 31 – janë në gjendjen, të cilën e dimë të gjithë. Ende nuk kemi rezultate çka ka ndodhur për këto katër pika dhe nuk mund të jepet një rekomandim kështu, pa sqarim edhe nga ana e auditorit.

Gani Koci – Rekomandoj që auditimi për AVU-në të jetë auditim i veçantë, në mënyrë që të mos ngatërrohet me ZKM-në. Edhe pse është në kuadër të ZKM-së, kjo Agjenci e ka buxhetin e veçantë, me të cilin menaxhon vetë dhe për të jep përgjegjësi. Edhe pse kjo Agjenci ka kaluar në kuadër të ZKM-së në fund të vitit 2009, nuk e përjashton nga përgjegjësia as ZKM-në, as AVU-në, në përmirësimin e performancës, të menaxhimit dhe në realizimin e të hyrave të përcaktuara.

Tri nga automjetet mund t'i kenë tejkaluar shpenzimet që mund të jenë enorme. Mirëpo Raporti i shpenzimeve financiare ofron të dhëna të sakta a ka tejkalime, a ka kufizime apo përmirësime në këtë fushë. Me tri automjete nuk mund të vijmë në konkluzionin se ka tejkalim. Kërkoj sqarim nga sekretari lidhur me këto tri vetura.

Fitim Krasniqi – sekretar i përgjithshëm – ZKM-së - Shumica e rekomandimeve, që kanë të bëjnë me ZKM-në, kanë të bëjnë me disa agjenci, të cilat funksionojnë si njësi të veçanta në kuadër të ZKM-së, që janë të pavarura në shpenzimin e buxhetit të tyre dhe që i kanë kryeshefat ekzekutivë. Këto agjenci i përgjigjen drejtpërdrejt kryeministrit. Çështja e legjislacionit është zgjidhur. Janë nxjerrë udhëzimet administrative dhe kanë hyrë në fuqi. Lidhur me tri veturat, të cilat sipas Raportit i kanë tejkaluar shpenzimet, është fjala për veturat e tri shoqatave (Shoqata e Invalidëve të Luftës, Shoqata e Dëshmorëve, Shoqata e Veteranëve të Luftës dhe shoqata të tjera të dala nga lufta). Përkundër vërejtjeve tona të shpeshta, këto shoqata e kanë të pamundur respektimin e limitit të përcaktuar deri në 1000 litra. Kam kërkuar që të merren masa, por kryeministri nuk e ka parë të arsyeshme, për shkak të angazhimeve që i kanë pasur këto tri shoqata në mbarëvajtjen e punës. Sa u përket shpenzimeve të tjera, nga viti 2009, janë krijuar disa mekanizma në Zyrën e Kryeministrit. Kjo ka sjellë shpenzime të tjera, si krijimi i Zyrës së Koordinatorit për Veriun, pastaj ZKM –ja, që i ka disa specifika të veçanta. Shumë manifestime bëhen nën patronantin e ZKM-së dhe e kemi të pamundur që këto organizime t'i parashohim në fillim të vitit.

Riza Smaka – Meqenëse ka shumë agjenci të pavarura, propozoi që me një vendim të veçantë të Kryeministrit të rregullohet që këto agjensione t'i përgjigjen edhe sekretarit të përgjithshëm lidhur me menaxhimin e financave. Ligji mund të ndryshohet, sepse u nënshtrohet rrethanave që ndryshojnë.

Safete Hadergjonaj – Ngriti çështjen a do të procedohen, apo jo, të gjitha raportet e auditorit në mbledhje plenare për shqyrtim.

Ndërsa, lidhur me AVU-në Komisioni mund të kërkojë nga ZAP-i ta bëjë një raport të performancës, në mënyrë që të shohë si është gjendja në këtë Agjenci.

Kryesuesi – Propozoi që Komisioni t'i rekomandojë Kryesisë së Kuvendit që shqyrtimi i raporteve të auditimit në mbledhje plenare të bëhet në një pikë të rendit të ditës, sepse kjo do të jetë një ngarkesë për Kuvendin.

Synavere Rysha – Tha, jo të gjitha raportet duhet të procedohen në mbledhje plenare për shqyrtim, se cilat raporte do të procedohen duhet të vendos Komisioni.

Komisioni nuk mund t'ia sugjerojë auditorit mënyrën e auditimit. Auditori nuk guxon të bjerë nën ndikimin e Komisionit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e nxori këtë

Përfundim

1. *Miratohet Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009.*
- obligohet ZKM-ja, të marrë masa përkatëse lidhur me rekomandimet e auditorit të përgjithshëm.
2. *Raporti i procedohet Kryesisë së Kuvendit, e cila do të vendosë nëse Raporti do të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare.*

5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Ismet Krasniqi - sekretar i Kuvendit - Opinioni i përgjithshëm i auditorit lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës është *“opinion i pakualifikuar”* dhe të gjeturat janë çështje, që nuk kanë reflektuar ndonjë ndikim material. Për vitin 2008 kemi pasur tetë rekomandime, nga të cilat pesë janë realizuar plotësisht, dy janë në fazën e realizimit, ndërsa një për fat të keq po përsëritet edhe në këtë vit. Nga 22 rekomandime, që i kemi pasur për vitin 2005, për vitin 2009 i kemi nëntë rekomandime. Auditori i përgjithshëm, komentet e KRK-së nuk i ka marrë për bazën e dy rekomandimeve - dy çështje, të cilat mendoj se duhet të trajtohen sot në këtë Komision. Çështja që ka të bëjë me këto dy rekomandime, është çështje për të cilën vendos Kryesia e Kuvendit. Rekomandimi 2 ka të bëjë me kompensimet, të cilat realizohen për deputetë. Lidhur me këtë e kemi zbatuar vendimin, i cili është propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe është miratuar nga Kryesia e Kuvendit. Me këtë deputetëve u paguhen shtesat, kompensimet për pjesëmarrjen dhe aktivitetet në Kuvend. Pra, rekomandimi dy, edhe pse nga ne është trajtuar si i paqëndrueshëm, megjithatë auditori ka vazhduar ta mbajë si rekomandim, i cili kërkon korrigjim në aktivitetet tona.

Rekomandimi gjashtë ka të bëjë me kompensimet për udhëtimet jashtë vendit - është fakt notor që ne mëditjet shtesë për udhëtime zyrtare jashtë vendit i bëjmë mbi bazën 30 %, ndërsa është një udhëzim administrativ i Qeverisë, me të cilin parashihet kompensimi deri 20 %. Sipas nesh edhe ky rekomandim nuk është i adresuar saktë, ngase ka mbështetje në vendimet e marra sipas Rregullores së Punës së Kuvendit. Këto vendime janë marrë nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës. Auditori ka sugjeruar diçka që është e pamundur - fjala është për rekomandimin numër tre, pika një - sipas së cilës duhet të krijohet një sistem i barkodeve në Kuvend, për të ditur se çka punohet, kur është fjala të mirëmbajtja ose servisimi i veturave. Ky rekomandim është i vështirë për zbatim, sepse vetë formimi i barkodeve nuk mund të jetë unik me kompanitë, të cilat i kryejnë servisimet. Kemi problem me dinamikën e realizimit të projekteve kapitale. Muajt tetor, nëntor dhe dhjetor kanë qenë muaj, në të cilët Kuvendi ka pasur aktivitet më të theksuar. Me qëllim që mjetet të mos shkojnë në suficit, kemi bërë edhe pagesa për punët e kryera në bazë të raporteve të Komisioneve, të cilat e kanë bërë pranimin e mallrave. Me këtë, në një farë mënyre, kemi arritur t'u ikim mjeteve nga suficiti dhe në të njëjtën kohë, punët të cilat kanë qenë të parapara me projekte, me planin e prokurimit të përfundojnë. Një problem, të cilin po e hasim si administratë, është ai i nënkritereve në procedurat e prokurimit. Pa qëllim mund të ketë lëshime teknike, por për të cilat mund të garantojmë se nuk do të kenë reflektime të shkeljeve të caktuara materiale.

Gani Koci – Lidhur me rekomandimin e auditorit për çështjen e pagave që thotë: *“...të mbështeten në praktika të mira”*, tha: Së paku duhet të jepen dy shembuj të atyre praktikave të mira. Ky nocion është shumë relativ. Kuvendi nxjerr vendime të veta dhe është shumë autonom në menaxhimin e financave, sidomos në përcaktimin e pagave dhe të mëditjeve për deputetë. Asnjë autoritet tjetër, as ZAP-i nuk ka të drejtë të dalë mbi vendimet e Kuvendit. Mbi vendimet e Kuvendit mund të dalë vetëm Gjykata Kushtetuese. Pajtohem me procedurat e prokurimit, me shkeljen e tyre, me mosmenaxhimin e drejtë. Ne e kemi shqyrtuar raportin gjashtëmujor të shpenzimeve buxhetore të Kuvendit dhe jemi shumë të pakënaqur me pjesën e shpenzimeve kapitale nga ajo që është projektuar - me këtë që është realizuar. Në këto drejtime ZAP-i ka për detyrë të na sugjerojë dhe të na udhëzojë. Nuk mund të thuhet se vendimet e Kuvendit duhet të jenë në përputhje me vendimet e jashtme. Cilat janë ato vendime të jashtme? Nëse auditori konstaton se janë shkelur vendimet e jashtme, është mirë të përmenden ato vendime, të cilat janë shkelur. Nëse është shkelur ligji, auditori duhet t'i referohet saktë ligjit dhe nenit të shkelur. Habit fakti se në pjesën më të madhe të raporteve të ZAP-it janë vetëm nëntë rekomandime dhe teksti i raporteve pothuajse është i njëjtë.

Riza Smaka – I paraqiti dy dimensione të vërejtjeve. Rekomandimi 2 thotë: *“...të sigurojë praktika të mira në menaxhimin e pagave ...”*. Këtu nuk ka profesionalizëm. Rekomandimi 3: *“...ta forcojë kontrollin e brendshëm para ekzekutimit të pagesave, në mënyrë që kontrolli të verifikojë dhe të parandalojë”*. Nga ky rekomandim, edhe pse jo i formuluar mirë, kuptohet se pagesat nuk bëhen në përputhje me kontratat ose vendimet. Kjo është më tepër hipotezë, është vërejtje për auditorin që në ardhmen të jetë i qartë. Ndërsa për sekretarin, nëse me të vërtetë ka

shpërputhje, këto duhet të menjanohen, sepse kur pagesat nuk bëhen në përputhje me kontratë, është shkelje. Rekomandimi katër, pika katër: “...vazhdohet praktika e filluar në zbatimin e penaleve të kontraktuara...”. Më këtë kryesi i punimeve do të jetë vigjilent dhe shumë i mobilizuar për ta kryer punën në afat të kontraktuar. Kjo ka qenë e panevojshme të futet si rekomandim nga auditori. Te rekomandimi gjashtë - *cilat janë vendimet e jashtme e cilat janë ato të brendshme?* Ky është një formulim shumë defektuoz i auditorit.

Synavere Rysha – Raporti mjaft mirë e pasqyron gjendjen. Numri i rekomandimeve mund të ndryshojë prej viti në vit, varësisht si i përmbushin institucionet ato rekomandime. Rekomandimi, që ka të bëjë me forcimin e kontrollit të brendshëm para ekzekutimit të pagesave, është rekomandim që thotë shumë. Pra, ka raste kur pagesat bëhen para kohe, pas kohe, pa kompletim të dosjes – në këtë rekomandim ka profesionalizëm. Pyeti: *Pse po vazhdoni pa realizim të qind për qind të buxhetit?* Shpenzimet për paga dhe mëditje janë realizuar 90%. *Pse parashihen vendet e punës, ose pse ndani paga kur pagat janë kategori fikse?* Pse parashihni 10% më tepër paga sesa është e nevojshme? Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë 88%. *Pse nuk janë 90% ose 95%?* Pse i lini të fjetura këto mjete? Shpenzimet kapitale janë vetëm 59%. *Pse nuk realizohen shpenzimet kapitale?* A ka qenë investim me vend, kur e keni bërë renovimin e objektit, duke filluar nga ndërimi i dyerve të lëkurës me këto dyer “të letrës”, të cilat janë kritikuar nga të gjithë deputetët?

Kryesuesi – Opinioni i përgjithshëm për pasqyrat financiare për KRK-në është “i pakualifikuar”. Shqetësuese është ridestinimi i mjeteve. Sipas Raportit është bërë ridestinim i mjeteve jashtë planit, d.m.th. nuk janë përfillur procedurat. Ky është keqpërdorim i parasë publike. Pagesa jo në pajtim me dinamikën e kontratave, pagesa për materialet dhe jo për punën e kryer. Kjo ka një dozë të pagesave me ndikim. Konstatimi i auditorit, që vetëm në dhjetor të paguhet 58% e masës së mjeteve për investime kapitale - si praktikë nuk është në rregull, sepse pagesa bëhet në muajin e fundit ngaqë dihet se zotimi bëhet vetëm deri më 10 dhjetor. Lidhur me pagesat që janë bërë në kundërshtim me vendimin e Qeverisë, duhet të konsultohet cili vendim është më meritues në këtë rast, sepse sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia ka të drejtë. Auditori ka mund të kërkojë materiale mbështetëse sepse gjithë puna e Kuvendit përcillet me materiale, si listat e nënshkrimeve për pagesa etj. Vonesat në kontrata - duhet të menjanohen si mangësi. Pyeti: *Operatorët ekonomikë, që veprojnë në Kuvend për furnizim, si për vetura, kulme etj., nga janë?*

Gani Koci – Rekomandimet 2 dhe 6 për Komisionin duhet të jenë të papranueshme. Asnjë vendim i jashtëm, përpos ligjeve dhe Kushtetutës nuk mund të jenë mbi vendimet e Kuvendit. Mënyra e pagesës së kontratave është çështje e rregulluar me ligj. Ridestinimi i mjeteve, që nuk kanë qenë më parë të planifikuara, është bërë me rishikimin e buxhetit. ZAP-i duhet ta shikojë Ligjin për buxhetin dhe rishikimin e tij, pastaj të konstatojë nëse ridestnimi është bërë në pajtim me ligjin ose jo. Prandaj, kur bëhet auditimi i një institucioni, duhet të kihen parasysh specifikat e atij institucioni buxhetor.

Kryesuesi - Lidhur me rekomandimet 2 dhe 6, kërkoi sqarim nga ZAP-i dhe nga sekretari i Kuvendit. Për auditorin e përgjithshëm është e obligueshme që ta ketë parasysh jo vetëm buxhetin fillestar, por edhe rishikimin e buxhetit. Rishikimi është vendim ligjor dhe miratohet në Kuvend. Një gjë që është vërejtur, një leje, një vendim, për disa vetura dhe kombi-bus, ka qenë në KBF. Në vend të tyre janë blerë automjete, që nuk janë të llojit, që janë lejuar nga KBF-ja.

Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit – Kur përpilohet buxheti, planifikohen pagat dhe mëditjet. Në paga përfshihen edhe shtesat. Ne kalkulojmë që të gjithë deputetët të marrin pjesë në mbledhje. Mosprania sanksionohet, nuk paguhet. Ne duhet të parashohim pjesëmarrje 100% të deputetëve në mbledhje plenare dhe në komisione. Në të kundërtën do të ballafaqohemi me problemin si t'i sigurojmë ato mjete.

Te kategoria mallra dhe shërbime e kemi paraparë një buxhet shtesë për komisionet parlamentare. Katër komisione parlamentare kanë nga 20.000 euro buxhet për shpenzime dhe 12 komisione kanë nga 10.000 euro. Komisionet kanë shpenzuar më pak se sa kanë pasur në

dispozicion. Për këtë çdo kryetar komisioni e ka marrë me shkresë shumën e këtyre mjeteve në dispozicion.

Tek investimet kapitale, problem permanent është projekti “Villa Gërmia”. Ky projekt ka mbetur në gjysmë. Nëse e ndërpresim kontinuitetin e të parashikuarit si projekt, duhen procedura të tjera, që nuk i duan më 200.000 ose 300.000 euro, por ndoshta 2 milionë euro. Kështu, kjo çështje, është gjithmonë projekt i paraparë për gjashtëmujorin e parë, me rishikim. Mjetet nga ky projekt adresohen dikund tjetër.

Synavere Rysha – *Kush është duke e paraparë këtë projekt?* Sekretari është ai që i propozon buxhetit. Për 3 vjet radhazi është paraparë si projekt në fillim të vitit, që pastaj të keni mundësi ta realizoni pa projekt në fund të vitit. Nëse ju nuk e keni paraparë listën e projekteve dhe në lista keni bërë ndryshime, keni bërë shkelje. Ky projekt nuk guxon të parashihet për vitin e ardhshëm ose duhet të realizohet, ose duhet të ndërpritet.

Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit – Buxhetin e Kuvendit të Kosovës e bën KBF-ja në bashkëpunim me administratën dhe e miraton Kryesia e Kuvendit. Sekretari në KBF e dorëzon një listë me kërkesa, mirëpo gjithnjë me kujdes te projekti “Villa Gërmia”, sepse do të jetë problem riaktivizimi. Këtu nuk ka shkelje, kjo mund të dokumentohet. Ky projekt nuk po përfundon, sepse ka filluar në një rrugë, për të cilën sekretari nuk ka përgjigje. Projekti i paraparë detyron që në fund të vitit, në 6 mujorin e dytë - në muajt korrik e gusht, që nuk ka aktivitete - në muajt e tjerë reflekton me një aktivitet shtesë.

Sa u përket “*dyerve të lëkurës*”, është një komision shumë kompetent, një kompani, që e ka konsultuar Kuvendi, si të trajtohen dyert dhe dritaret e Kuvendit, në pjesën e brendshme. Në bazë të rekomandimit të kompanisë dyert janë ruajtur dhe sistemuar dhe në një donacion eventuale, që mund të sigurohet do të vendosen, me një ripunim. Vetëm përpunimi i atyre 20 dyerve e ka tejkaluar shumën e të gjitha dyerve dhe të dritareve, që janë ndërruar. Dyert janë vendosur me tender dhe me komision vlerësues, kanë një kualitet të lartë dhe mbajmë përgjegjësi për këtë.

Ridestanimet gjithmonë kanë pasur arsyetim dhe gjithmonë kanë pasur mbështetje nga KBF-ja dhe nga Kryesia.

Pagesat me ndikim janë bërë në fund të vitit për mallrat e pranuar në bazë të një vendimi, që komisionet kanë bërë pranimin e mallrave për punë, që nuk kanë mbërritur të përfundohen deri më 31 dhjetor 2009. Do të thotë për mallin, që e kemi marrë, në bazë të vlerësimit, të konsultimeve dhe të komisionit pranues është bërë pranimi i mallit dhe ai mall është paguar para 31 dhjetorit, ndërsa puna për vendosje është paguar pas pranimit teknik të projekteve, të cilat janë realizuar. Do të thotë, pagesa në ndikim, nuk ma jep atributin e drejtpërdrejtë për ndikim të ndonjë interference ose interesi, por është bërë në mënyrë që mjetet të mos shkojnë në suficit dhe projektet të mos ngelin dhe të fillohet me një tender të ri dhe me një 50-ditësh deri sa të përmbillen procedurat. I kemi konsultuar KRPP-në dhe OSHP-në. Na është thënë se mund të bëjmë pagesa për mallrat e pranuar dhe janë identifikuar si pagesa me ndikim. Qëndroj pas asaj se pagesat janë bërë me konstatimin e komisionit prej 3 anëtarësh për pranim malli.

Çështja e prejardhjes së operatorëve. Është komisioni për vlerësim i përbërë prej 3 anëtarësh që e kanë bërë përzgjedhjen e lëndëve për operatorët, që kanë ofertuar. Koincidenca mund të jetë e rastit ose e qëllimshme, por nuk mohoj as nuk konfirmoj diçka tendencioze. E gjitha mund të jetë relative. Unë jam bazuar në raportet e Komisionit, të nënshkruara nga zyrtari i prokurimit, i cili është përgjegjës për kontratat në bazë të LPP-së, e të zbatuara nga entitetet.

Ibrahim Gjylderen, zv.auditor - ZAP – Rekomandimi 2, kryesisht ka të bëjë me pagën e 13-të. Ky konkluzion është marrë ndoshta në mungesë të një legjislacioni lidhur me të drejtën e organizatave buxhetore që të marrin vendime për pagën e 13-të. Në Rregulloren e Kuvendit parashihet se Kryesia e Kuvendit mund të vendosë për deputetët dhe për stafin parlamentar, por nuk përfshihet stafi administrativ, i cili ka qenë i përfshirë me pagën e 13-të. Sa i përket numrit të rekomandimeve, kemi një raport standard, në të cilin përfshihen 9 fusha dhe për secilën fushë është një rekomandim. Secili rekomandim ka nënrekomandime. Rekomandimet përsëriten, kur përsëriten edhe të gjeturat. Kemi bërë vërejtje sa i përket ridestinitimit në kuptimin e planit të prokurimit. E dimë se në fillim bëhet plani i prokurimit dhe gjatë vitit me destinim ka pasur

ndryshim të këtij plani dhe janë implementuar plane të tjera me një buxhet që është paraparë për diçka krejt tjetër.

Sa u përket rekomandimeve, që i dëgjuam këtu, do t'i marrim parasysh. E dimë se edhe ne nuk jemi të përsosur. Ka edhe shumë rrugë, për ta arritur nivelin që duhet.

Riza Smaka – Rekomandimet që përsëriten, duhet të theksohen qartë, sepse është fjala për shkelje dhe për neglizhencë të madhe. Shumë rekomandime serioze nuk përfillen fare, as nga prokuroria.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 03/4000/Ra.029, dt. 02. 07. 2010, me vërejtjet në rekomandimet dy dhe gjashtë të Raportit të auditorit.*
- 3. Raporti i procedohet Kryesisë së Kuvendit, e cila do të vendosë nëse raporti do të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare.*

Mbledhja përfundoi në orën 15:10

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Haki Shatri